

Ai rritet por gjithmonë i kullojnë jargë nga goja, ç'farë të bëj?

Që prej shumë muajsh tashmë, Leon-i ka jashtë mase jargë.

Nëna e Léon-it tregon:

Kujtojmë periudha disi të ngjashme me fëmijët e mëdhenj, por nuk mbajmë mend që të kenë zgjatur kaq shumë. Fillimisht, menduam se kjo ndodhte për shkak të dhëmbëve, por tani që dhëmbët kanë dalë mirë, na linden pyetje. Unë kam prirjen t'i them atij t'i gëlltisë jargët sapo të filloje të jargoset, por kjo nuk është shumë efektive, do të më duhej t'i them gjatë gjithë ditës. I ati ia fshin, i vendos një grykashkë, por unë nuk mund të imagjinoj që pas disa muajsh ai të shkojë në shkollë me grykashkë në qafë.

Nëna e Leon-it

Kjo situatë konstatohet shumë shpesh në konsultimet për fëmijët e vegjël. Profesionistët pyeten rregullisht për moshën në të cilën supozohet të zhduken jargët . Nëse jargosja njihet në zhvillimin normal e të vegjëlve, kur supozohet që të zhduket ajo?

A ka një "moshë për të jargosur"?

Kur zhvillimi dhe shëndeti i fëmijës janë pa ndonjë veçanti, do të vërehet një jargosje rreth moshës 6-8 muajsh. Një jargëzim ndodh gjatë daljes së dhëmbëve, gjatë periudhës kur fillohet t'i jepet ushqimi i larmishëm, kur goja përsoset për të kafshuar dhe më pas për të përthypur. Pas 2 vjetësh, fëmijët në përgjithësi ndalojnë jargët: përsosja e lëvizjeve të gojës ua mundëson këtë gjë.

Si përkufizohet jargëzimi?

Çdo individ sekreton pështymë dhe kur ajo rrjedh nga goja, do të flitet për "jargë". Pra, jargëzimi është më shpesh pasojë e keq kontrollit të pështymës (gëlltitje). Mund të vëmë re gjithashtu situata ku pacienti e le t' i rrjedhë pështyma sepse ka shumë për të menaxhuar njëherësh (pështymë e tepërt). Tek fëmija, sasia e jargës me shumicë ose e moderuar shqetëson gjithmonë familjen e tij.

Cilat janë shkaqet e këtij jargëzimi?

Mund të identifikojmë dy familje të mëdha shkaqesh që ndihmojnë për të kuptuar këtë situatë tek fëmijët e vegjël.

- Ndërkohë që fëmija rritet, ai merr gjithnjë e më shumë dijeni për të vepruar, duke përfshirë edhe ato që e lejojnë të kryejë lëvizje gjithnjë e më të sakta me gojën e tij. Këto janë lëvizje që vërehen kur fëmija ha ose flet, për shembull (lëvizjet e gojës). Ndonjëherë, këto mësimë janë të vështira dhe kjo sjell jargëzim.
- Në disa sëmundje, veçanërisht ato të tretjes (Refluks Gastro-Esophageal-RGO-, plagë të vogla të ezofagut ose orofaringeal), gëlltitja (kapërcimi i pështymës) shkakton një shqetësim, i cili ndonjëherë e bën fëmijën të gëlltisë më pak dhe rrjedhimisht të jargosë.

Prandaj, një fëmijë mund të jargosë ose sepse nuk di mirë të gëlltisë automatikisht pështymën e saj, ose sepse është e pakëndshme për ta bërë këtë.

Cilat janë pasojat e jargëzimit?

Pasojat e para janë sociale: një fëmijë që jargoset, duhet pranuar që është pak e këndshme për rrethin e tij. Kjo mund të sjellë përgjigje pak të përshtatshme. T'i thuash një fëmijë "të ndalojë jargën" është, për shembull, logjike, por jo efikase. Të mos jargosesh për fat të keq nuk bëhet përmes kontrollit vullnetar të pështymës tuaj. E gjithë kjo bëhet normalisht padashur.

Në veçanti, fëmija, duke nxjerrë jargë vazhdimisht ose shpesh gjatë ditës, do të mësohet të ketë një mjekër të lagur dhe ndjeshmëria e tij do të ulet dukshëm. Ndryshe nga bashkëmoshatarët e tij që nuk i lëshojnë jargët, fëmija që jargoset përfundon duke mos e ndjerë më lagështinë e krijuar pasi mësohet me të, dhe për këtë arsye nuk mund të perceptojë, vetë, shenjat e para të jargosjes së tij. Së fundi, fëmija që jargoset, duke mos e gëlltitur në mënyrë automatike pështymën, pakëson lëvizjet e gojës së tij. Ky fëmijë e kalon ditën me gojë hapur, kështu që merr frymë me gojë në vend të hundës. Ai është më i prekshëm ndaj infeksioneve.

Është një rreth i tërë vicioz që do të prekë sferën e tij të ORL. Fëmija do të ketë pak pështymë që mbetet në gojë e cila mund t'i dëmtojë dhëmbët. Gjuha e tij, pak aktive, do të jetë më pak tonike dhe kjo mund të ndikojë në kuptueshmërinë e të folurit ose lehtësinë e tij në të ngrënë. Cilado qoftë arsyeja e jargosjes, është e rëndësishme të kujdeseni shpejt për të në mënyrë që të mos krijohet një rreth vicioz.

Me kë duhet të konsultoheni për jargët e një fëmije?

Fillimisht, është e dëshirueshme një konsultë mjekësore. Mjeku i përgjithshëm ose pediatri do të jenë në gjendje të kërkojnë shkaqet organike dhe, nëse është e nevojshme, të orientojnë për të bërë bilance të tjera, veçanërisht një kontroll ORL, apo edhe në një kontroll neuropediatrik.

Në një hap të dytë, mjeku ka të ngjarë t'ju rekomandojë te një logoped për të kryer "një kontroll të funksioneve oromyofaciale dhe të shprehurit gojor", ose edhe "një vlerësim i të folurit" në varësi të çdo brishtësie tjetër që ndoshta ai do të identifikojë në zhvillimin e fëmijës.

Në konsultë, ortofonisti do të presë prindërit me fëmijën për të diskutuar vështirësitë e vërejtura dhe zhvillimin e tyre. Ai do të ekzaminojë gjithashtu gojën, por edhe fytyrën, mënyrën e të ngrënit apo të folurit. Nëpërmjet këtyre ekzaminimeve të ndryshme, ortofonisti do të bëjë vlerësimin e aftësive të fëmijës. Ai do të kërkojë të kuptojë shkaqet e jargosjes së vërejtur. Do të ndihmojë fëmijën të përmirësojë këtë funksion duke i propozuar trajtime të përshtatura për situatën e tij me pjesëmarrjen e prindërve.

Ndërkohë, si të veprohet në të përditshmen?

Rrethi që shoqëron një fëmijë që ka jargë mund të sugjerojë disa aktivitete të përditshme për të evituar që ky rreth vicioz të veprojë.

Biberoni do të bëjë që të ketë lëvizje më pak tonike të gojës dhe të gjuhës. Prandaj këshillohet fuqimisht ta mbani atë vetëm për momentet kur duhet të vihet në gjumë fëmija apo për momente qetësimi të shkurtër.

Higjiena e hundës (shfryrja, larja e hundës) që i bëhet fëmijës disa herë në ditë, veçanërisht në dimër, rekomandohet me qëllim për të kufizuar infeksionet. Një hundë

e çliruar dhe e pastër do të mundësojë frymëmarrje më natyrale përmes saj. Pra, goja do të mbyllet dhe do ta përmbajë më lehtë pështymën.

Higjiena e gojës dhe larja e dhëmbëve do të mbikëqyren dhe kontrollohen nga prindërit. Kjo higjienë do të mbrojë dhëmbët e ekspozuar ndaj pështymës së ndenjtur. Larja e dhëmbëve do të zhvillojë ndjesitë në gojën e fëmijës dhe do t'i mundësojë atij të jetë i vetëdijshëm për elementët që e përbëjnë atë.

Së fundi, të gjitha lojërat e gojës mund të inkurajohen: qoftë për të fryrë, për të thithur, për të bërë ngërdheshje, për zhurma apo për të kënduar, të gjitha këto aktivitete do të ndihmojnë për të mirëmbajtur aparatën "fytyrë dhe gojë" të fëmijës duke u kënaqur dhe pa mundim.

Nëse fëmijët pa ndonjë veçanti në zhvillim e tyre i ndalojnë jargët në më të shumtën e rasteve, pas moshës 2 vjeç, është mirë të konsultoheni me mjekun tuaj nëse ato vazhdojnë më tej. Ai do të kërkojë shkaqet e mundshme mjekësore dhe t'ju drejtojë, nëse është e nevojshme, për të bërë kontrollet e domosdoshme shtesë që mund t'ju ofrojnë ndihma më specifike.

Ndërkohë, të jini të sigurt se mund të ndërhyni në mënyrë efektive duke u mobilizuar çdo ditë rreth disa trajtimeve të caktuara higjienike, por edhe rreth lojërave të gojës me fëmijën tuaj.